



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 36, paragrafi 36.1 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

th ë r r e t

mbledhjen e **tretë** të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më **07.04.2015** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 2.

Për këtë mbledhje **p r o p o z o n** këtë

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar përmbledhës buxhetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2014;
3. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2014 në vitin 2015;
4. Propozimvendimi për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në Planin rregullues "Arbëria 3";
5. Propozimvendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria";
6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë;
7. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndërtimin e objektit të IKAP-së;
8. Propozimvendimet për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me pronat në pronësi të personave fizikë / juridikë;
9. Marrëveshja e bashkëpunimit me Helvetas;
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 06 - 70769, më 30.03.2015

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.